



BASHKIA VAU DEJES

RELACION

Mbi domosdoshmërinë e investimeve të shtuara dhe miratimin e ndryshimit të vkb nr 79 date 24.12.2020 "Miratimin e nivelit të pagave për funksionaret e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ" të bashkisë vau dejes për vitin 2021 .per miratimin e ndryshimit të shteses së pozicionit, nga rritja e pagave ,ne arsimin parashkollor(janar-dhjetor 2021)

Në mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja c , neni 18, 54 shkronja dh, neni 55 pika 3 , neni 64 shkronja c,të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";neni 45, te ligjit nr, 68/2017, Per financat e veteqeverisjes vendore, neni 44, te ligjit Nr.9936 datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë,te ndryshuar" ligjin nr, 10296, date 08,07,2010, Per menaxhimin financiar dhe kontrollin , te ndryshuar, ligjin nr, 137/2020 date 16,11,2020, Per buxhetin e vitit 2021,Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr, 9 datë 20,03,2018, për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, neni, 100. Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore: a) Ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ", Vendim nr. 1149, datë 24.12.2020,Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë,në arsimin parauniversitar", të ndryshuar. Ne VKM nr.187, date 08.03.2017, "Per miratimin e struktures se institucioneve ne varesi te ministrave te linjes dhe administrtaen e prefektit", të ndryshuar.

Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 25.01.2021 "Per zbatimin e buxhetit 2021"Ne Vendimin e Keshillit te Bashkise Vau-Dejes Nr, 80 date 24,12,2020 " Per miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2021-2023, numrin e punonjesve per Bashkine Vau- Dejes " Te miratuar per shprehje ligjishmërie nga Prefektura Shkoder me shkrese nr, 19/1 date 18.01.2021"

Spektori i Investimeve publike mendon të shtojë realizimin e katër objekteve për vitin 2021

1. **"Blerje kamion veteshkarkues dhe rimorkiator per eskavator"**
2. Objektin: **"Ndriçim rrugor i qendres së fshatit Spathar"**
3. Objektin: **"Kolaudimi i Ujesjellesit Vau Dejes"**

4. **Objekti: "Projektim objekti: Ndertim trotuari me ndricim dhe gjelberim ne lagjen Park te qytetit Vau Dejes"**

1. **"Blerje kamion veteshkarkues dhe rimorkiator per eskavator"** është investim I domsdoshëm për Bashkinë Vau Dejës, pasi janë mjete mbështetëse të nevojshme për realizimin e prishjeve, germim e pastrim kanalesh, investime të cilat përkrahin zhvillimin e bujqësisë në territorin tonë.
2. Objekti: **"Ndrëim rrugor i qendres se fshatit Spathar"** është i domsdoshëm, në kuadër të angazhimit të bashkisë për ndriçimin e të gjithë fshatrave në territorin e saj.
3. Objekti: **"Kolaudimi i Ujesjellesit Vau Dejes"**

Punimet për ndërtimin e ujësjellësit Vau Dejës kanë filluar në vitin 2019 dhe janë mbyllur me 02.02.2021. Për mbylljen e plotë të këtij investimi duhet të realizohet kolaudimi I objektit, në mënyrë që bashkia të marrë në dorëzim punimet e kryera nga firma e kontraktuar.

4. Objekti: **"Projektim objekti: Ndertim trotuari me ndricim dhe gjelberim ne lagjen Park te qytetit Vau Dejes"**, është një investim i domsdoshëm për qytetin e Vau Dejës pasi ka një përqendrim të madh të banorëve. Për përmirësimin e sigurisë së këmbësoreve dhe automjeteve është e nevojshme të realizohet studimi I zonës dhe hartimi i projektit, në mënyrë që të realizohet një investim cilësor në këtë zonë.

KRYETAR
Mark BABANI

